



Situata e garantimit të shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuar në nivel lokal

Dokument orientues i ndërhyrjeve, në drejtim të përmirësimit të gjendjes në fushën e arsimit për fëmijët me aftësi të kufizuar.

Tiranë, Prill 2018

PASQYRA E LËNDËS

- I. Hyrje
- II. Situata në fushën e arsimit për fëmijët me aftësi të kufizuara në 10 Bashki të vendit.
- III. Ndërhyrje në nivel qendror për të garantuar arsim cilësor gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara.

I. HYRJJE

Censusi 2011 në Shqipëri nxori në pah se 6,2% e popullsisë mbi moshën 15 vjeç (2 084 137 persona) është e shoqëruar nga një formë e aftësisë së kufizuar. Të dhënat e fundit të Shërbimit Social Shtetëror tregojnë se janë identifikuar 140840 persona me aftësi të kufizuara, prej të cilëve 67741 janë përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe 73099 janë përfitues të pagesave për shkak të të qenit invalidë pune. 14578 fëmijë janë të regjistruar si përfitues të pagesave të aftësisë së kufizuar. Kjo shifër përbën afërsisht 2% të numrit të fëmijëve në vend (n=738990).

Studimi i realizuar nga World Vision dhe Save the Children¹, i cili synoi në matjen e përhapjes së aftësisë së kufizuar tek fëmijët, identifikoi se 10,4% e fëmijëve të grupmoshës 2-17 vjeç hasin të paktën një vështirësi të lartë për të kryer një aktivitet ose nuk arrijnë ta kryejnë fare atë.

Studimi gjithashtu tregoi se vetëm 7,8% e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Shqipëri marrin shërbim nga qendra sociale, ndërsa 75% e fëmijëve me aftësi të kufizuar ndjekin çerdhen, kopshtin ose shkollën. Ndërkohë, i njëjti² studim bëri një vlerësim edhe të cilësisë së shërbimeve arsimore, shoqërore e shëndetësore, duke vënë në dukje faktin se pavarësisht se niveli i ndjekjes së shkollës tregon se është më i lartë krahasuar me të dhënat e viteve të mëparshme, fëmijët me aftësi të kufizuara ndërpresin shkollën më shpejt se sa fëmijët e tjerë që nuk kanë probleme, duke vënë në dukje faktin që shkollat nuk janë mjaftueshëm gjithëpërfshirëse dhe kanë mungesa në ekspertizë apo në shërbime speciale mbështetëse. 26,2% dhe 14,6% e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara janë të pakënaqur ose krejtësisht të pakënaqur me kushtet infrastrukturore të godinës të institucionit arsimor dhe largësisë që duhet përshkuar për ta frekuentuar atë.

Një në 2 fëmijë me aftësi të kufizuar përjetojnë diskriminim në komunitet (52,9%), në institucione arsimore (52,4%) dhe gjatë lojës me bashkëmoshatarë (54,9%)

Gjatë viteve të fundit, në Shqipëri janë hartuar një sërë ligjesh dhe politikash, lidhur me promovimin mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara si Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016 – 2020 (2016) Ligji për

¹ World Vision në Shqipëri dhe Kosovë dhe Save the Children në Shqipëri. (2018). “Aftësia e kufizuar te fëmijët 2 - 17 vjeç në Shqipëri: Prevalenca dhe cilësia e shërbimeve mbështetëse sipas perceptimit të prindërve.”

² 36,5% e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të identifikuar përmes këtij studimi, janë të pakënaqur ose krejtësisht të pakënaqur me shpenzimet që duhet të bëjnë për të mundësuar frekuentimin e institucioneve të arsimit nga ana e fëmijës, 26,2% dhe 14,6% e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara janë të pakënaqur ose krejtësisht të pakënaqur me kushtet infrastrukturore të godinës të institucionit arsimor dhe largësisë që duhet përshkuar për ta frekuentuar atë. Gjithashtu, prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuar janë të pakënaqur me përparimin e fëmijës në arsim (19,4%); me nivelin e përshtatjes së mësimdhënies me nevojat dhe zhvillimin e fëmijës (13,3%) dhe me respektin e shfaqur për këta fëmijë nga stafi arsimor (6,3%). 1 në 2 fëmijë me aftësi të kufizuar përjetojnë diskriminim në komunitet (52,9%), në institucione arsimore (52,4%) dhe gjatë lojës me bashkëmoshatarë (54,9)

Arsimin Parauniversitar(2012), Strategjia e Mbrojtjes Sociale2015-2020(2015) Dokumenti Politik për Përfshirjen Sociale(DPPS 2016-2020), Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë (2014), Ligji për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë (2016). Të gjithë këto dokumente, në masën që trajtojnë çështje të lidhura me personat me aftësi të kufizuara, kanë në themel të tyre vënien në jetë të orientimeve të dhëna në Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPK), të ratifikuar në Dhjetor 2012, nga Qeveria Shqiptare. Neni 24 i Konventës fokusohet tek arsimi dhe i kërkon vendeve që të njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për arsimim. Me qëllim, realizimin e kësaj të drejte pa diskriminim dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, Shtetet Palë duhet të sigurojnë një sistem arsimor gjithëpërfshirës në të gjitha nivelet dhe të garantojnë të mësuarit gjatë gjithë jetës. Neni 24 thekson tre elemente të rëndësishme që vendet duhet të marrin në konsideratë dhe të zbatojnë në sistemet e tyre arsimore. Ato janë (a) E drejta për arsim gjithëpërfshirës për të gjithë nxënësit në të gjitha fazat e arsimimit të tyre; (b) Sigurimi i akomodimit të arsyeshëm për të mundësuar arsimin gjithëpërfshirës; (c) Sigurimi i masave të nevojshme mbështetëse.

Ka rrugë të ndryshme për të arritur arsimin gjithëpërfshirës (a) Është e rëndësishme që politikat dhe praktikat të individualizohen dhe t'ju përgjigjen nevojave specifike të fëmijëve, pavarësisht nga niveli i vështirësive dhe funksionimit të tyre; (b) Për të kuptuar dhe zbatuar arsimin gjithëpërfshirës, është thelbësore të zhvillohen programe shkëmbimi, të cilat duhet të përfshijnë nëpunësit civilë, mësuesit, drejtorët e shkollave, prindërit dhe organizatat e personave me aftësi të kufizuara, si dhe stafet që punojnë në sektorin e arsimit special; (c) Në një perspektivë të të drejtave të njeriut, arsimi gjithëpërfshirës nuk duhet të shihet vetëm si një detyrim, por edhe si një mundësi për të edukuar të gjithë fëmijët për të drejtat e njeriut dhe respektin për të gjithë. Është e rëndësishme të kuptohet se për të ndryshuar sistemin dhe për të siguruar përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme, duhet të zhvillohet një revolucion në mendjet e njerëzve përfshirë familjet dhe organizatat e personave me aftësi të kufizuara, përveç autoriteteve përgjegjëse publike, drejtorëve të shkollave, stafeve, pjesë e sistemit arsimor dhe sindikatave. Në sistemin arsimor, në shkollat e zakonshme, ende ka konfuzion midis integritit dhe përfshirjes. Integriti është çështje lokacioni - vendosja e nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme ku ata duhet të përshtaten me mënyrën ekzistuese të mësimdhënies dhe të të mësuarit, si edhe me organizimin e shkollës. Përfshirja, nga ana tjetër, kërkon përshtatjen e sistemit për të plotësuar nevojat e nxënësit me aftësi të kufizuara. Mjedisi, mësimdhënia dhe të mësuarit, organizimi i shkollës, mbështetja e bashkëmoshatarëve dhe sistemit arsimor duhet të ndryshohen në mënyrë sistematike për të hequr pengesat për nxënësit me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ata të maksimizojnë arritjet e tyre akademike dhe sociale. Një qasje gjithëpërfshirëse është e dobishme për të gjithë studentët, pavarësisht nëse janë me aftësi të kufizuara ose jo, ose nëse kanë vështirësi në të mësuar apo jo. Ende nuk kuptohet se çfarë do të thotë

akomodim/përshtatje e arsyeshme në sistemin arsimor dhe nevojat e nxënësve për rregullime/ përshtatje, përmbushen vetëm pjesërisht.

Kuadri ligjor e politik, qasja e re dhe konceptet e KDPAK, shpeshherë, mbeten të panjohura në disa prej segmenteve në nivel qendror, dhe aq më tepër në nivelin vendor. Pavarësisht përpjekjeve dhe masave të marra për ndryshim, komuniteti i personave me aftësi të kufizuara ende vazhdon të hasë vështirësi, të cilat i pengojnë ata të jenë qytetarë me të drejta e mundësi të barabarta me të gjithë pjesën tjetër të shoqërisë. Qytetarët me aftësi të kufizuara, përballen me shumë pengesa në përpjekjet e tyre për t'u përfshirë në jetën social - ekonomike, politike e kulturore të vendit. Vështirësitë, ndër të tjera, kanë të bëjnë me: (a) mungesën e aksesueshmërisë e, për pasojë, përfshirjes e pjesëmarrjes së tyre në nivele të ulëta në të gjitha sferat e jetës; (b) nivelin e ulët të të ardhurave; (c) mungesën e shërbimeve të lidhura me rehabilitimin e përfshirjen; (d) mungesën e shërbimeve në komunitetet ku ata jetojnë; (f) diskriminimin, stigmatizimin e paragjykimet.

Për të ndihmuar në orientimin e ndërhyrjeve të duhura të cilat garantojnë përfshirjen sociale përmes përmirësimit të shërbimeve shoqërore, shëndetësore dhe arsimore për personat me aftësi të kufizuara, me fokus të veçantë fëmijët, World Vision, Shqipëri në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të kufizuara, morën iniciativën të hartojnë një set Planesh Vendore me fokus aftësinë e kufizuar në 10 Bashki të vendit. Planet Lokale u zhvilluan respektivisht për Bashkitë e Durrësit, Vlorës, Korçës, Elbasanit, Kurbinit, Librazhdit, Lezhës, Kamzës, Dibrës e Shkodrës dhe targetojnë rreth 49, 595 persona me aftësi të kufizuara, përfitues nga skemat e pagesave të aftësisë së kufizuar(23121) dhe nga skema e invalidëve të punës(26474) në këto 10 Bashki. Prej tyre, gati një e dhjeta janë fëmijë (9,97%, n=4946).

Hartimi i Planeve Lokale në fushën e aftësisë së kufizuar, një ndërhyrje specifike kjo, shkon në linjë me kuadrin ligjor e politik, të cilin qeveria shqiptare ka miratuar dhe po përpqet të zbatohet me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri. Po ashtu, ky dokument është një vlerë e shtuar për Planet Sociale, të cilat janë përgatitur dhe po vazhdojnë të përgatiten për çdo Bashki të vendit. Fushat kryesore ku u fokusua puna ishin ato të: a) Shërbimeve Shoqërore; b) Shërbimeve shëndetësore; c) Arsimi. Për çdo fushë, u mbledhën të dhëna administrative nga aktorë të pushtetit vendor e rajonal si edhe qendra që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara, qofshin këto me mbështetje shtetërore, shoqëria civile apo institucione fetare. Bazuar në situatën e gjetur, si edhe në kuadrin ligjor e politik të miratuar nga qeveria Shqiptare, u propozuan

ndërhyrjet kryesore, të cilat janë të detyrueshme të zbatohen në nivel vendor e rajonal me qëllim realizimin e detyrimeve të marra përsipër me qëllim realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në fushat e Arsimit, Shërbimeve Shoqërore dhe Shërbimeve Shëndetësore. Ndërkohë, përmbushja e ndërhyrjeve në nivel vendor shpesh është e kushtëzuar dhe kërkon realizimin e ndërhyrjeve nga Institucionet shtetërore në nivel qendror.

Qëllimi i këtij dokumenti është të ofrojë një pasqyrë të përmbledhur të situatës së shërbimeve arsimore për personat me aftësi të kufizuara në 10 Bashkitë e sipërpërmendura, si edhe të orientojë ndërhyrje nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, me qëllim përmirësimin e kësaj situatë në drejtim të përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor.

II. SITUATA NË FUSHËN E ARSIMIT PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË 10 BASHKI TË VENDIT

Me gjithë hapat e ndërmarrë për të garantuar arsim gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara, prindërit dhe personat me aftësi të kufizuara të përfshirë në këtë vlerësim, sikurse edhe prindërit e përfshirë në studimin e realizuar nga World Vision Albania dhe Save the Children në Shqipëri (2018), janë ende të pakënaqur nga cilësia e arsimimit të fëmijëve të tyre në shkollat gjithëpërfshirëse³.

Gjatë procesit të vlerësimit të situatës së arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në 10 Bashki, u evidentuan një sërë sfidash që kërkojnë ndërhyrje për adresimin e tyre.

³ Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuar janë të pakënaqur ose krejtësisht të pakënaqur me përparimin e fëmijës në arsim (19,4%), me nivelin e përshtatjes së mësimdhënies me nevojat dhe zhvillimin e fëmijës (13,3%) dhe respektin e shfaqur nga stafi arsimor (6,3%).

2. Arsyet kryesore për mosndjekjen e shërbimit arsimor të vlerësuara nga prindërit e fëmijëve me ose pa aftësi të kufizuara janë: mospërballimi i kostove financiare që lidhen me marrjen e shërbimit (29%); vështirësitë në përshtatje (17,8%); si dhe cilësia e papërshtatshme e shërbimeve (16,8%). Pavarësisht se në përqindje më të vogël, është e rëndësishme të theksojmë se gjatë anketimit u identifikuan raste të fëmijëve të cilët kishin braktisur arsimin për shkak të sjelljeve diskriminuese (12,1%) ose mohimit të shërbimit (6,5%)

1. Të dhënat e DAR në të 10 Bashkitë ku u punua për hartimin e planeve lokale, treguan se fëmijët me aftësi të kufizuara, në një masë të konsiderueshme janë ende jashtë sistemit arsimor. Vetëm 1255 fëmijë me aftësi të kufizuara, të pajisur me vërtetim të KMCAP, janë të regjistruar në shkolla të zakonshme dhe kopshte. Niveli i përfshirjes është i ndryshëm në zona të ndryshme, në Bashkinë Lezhë, 60% (n=165) e fëmijëve me aftësi të kufizuara në moshë shkollore, nuk janë pjesë e sistemit arsimor po kështu në Bashkinë Vlorë, 65% (n=173) fëmijë me aftësi të kufizuara, nuk janë ende pjesë e sistemit arsimor. Fëmijët me aftësi të kufizuara, veçanërisht fëmijët me një shkallë më të lartë vështirësie ose aftësi të kufizuara të shumëfishta, përjetojnë pengesa të mëdha në qasjen në shkolla. Sipas studimit të World Vision dhe Save the Children (2017), pavarësisht se niveli i ndjekjes së shkollës tregon që është më i lartë krahasuar me të dhënat e viteve të mëparshme, fëmijët me aftësi të kufizuara ndërpresin shkollën më shpejt se sa fëmijët e tjerë që nuk kanë probleme. Bazuar në vlerësimet e bëra nga komisioni multidisiplinor⁴, fëmijët me aftësi të kufizuara të regjistruar në shkolla janë kryesisht fëmijë me çrregullime të spektrit autik, aftësi të kufizuara intelektuale, me dëmtim ose humbje të dëgjimit, dëmtim të shikimit, aftësi të kufizuara fizike, me aftësi të kufizuara fizike e mendore, epilepsi, sindromën Down, paraplegji etj.
2. DAR i raporton të dhënat që disponon në MASR,tre herë në vit, në një bazë të dhënash me tregues të unifikuar⁵ të cilët japin informacion për moshën, llojin e aftësisë së kufizuar, duke e kategorizuar në aftësi të kufizuar mendore dhe fizike dhe fëmijë që ndjekin shkolla speciale ciklin shkollor,minoritetet etnike, fëmijë të rikthyer nga emigracioni dhe gjininë. Ka përpjekje nga DAR të ndryshme në vend, por të pakoordinuara dhe të paunifikuara nga MASR, për t'i plotësuar këto të dhëna me tregues specifikë⁶ bazuar në Klasifikimin Ndërkombëtar të Funkcionalitetit (KNF), për nevojat në të mësuar të secilit fëmije,

⁴ Ngritur pranë çdo DAR, në zbatim të Ligjit nr.69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,

⁵Baza e të dhënave ekzistuese është e unifikuar nga MAS per të gjitha DAR e ZA me qëllim raportimin e të dhënave për numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara të përfshirë në kopshe dhe shkolla të zakonshme në vend.

⁶Në bazë të këtyre treguesve identifikohen nevoja specifike, përmendur (a) prania e specialistëve që do të ofronin shërbime terapeutike, sikurse janë logopedistët që do të mundësonin terapinë e të folurit; (b) tekste në formate të ndryshme, përfshirë formate të thjeshtëzuara, formate me gërma të zmadhuara, tekste në Brail ose në audio, etj; (c) materiale didaktike të cilat do të lehtësonin procesin e mësimdhënies dhe të të nxëniet të informacionit; (d) mësues mbështetës;(e) interpretë të gjuhës së shenjave; (f) ambiente të cilat do të krijonin mundësi për punë individuale për të qenë sa më pranë nivelit të bashkëmohatarëve pa aftësi të kufizuara në klasë, si edhe për tu relaksuar apo për të përfituar shërbime të tjera mbështetëse, përfshirë mbështetje psikosociale, fizioterapi, logopedi etj.

përfshirë nevojat për shërbime mbështetëse në varësi të aftësisë së kufizuar, bazuar edhe në detyrimi ligjor (VKM nr.708, datë 26.08.2015⁷) për ta bërë këtë.

3. Ende në DAR, por edhe në MASR, nuk ka një strukturë ose të paktën 1 specialist, në zbatim edhe të akteve nënligjore⁸ që të ketë përgjegjësinë për të ndjekur vetëm problematikën e gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara, ose ta ketë atë si detyrë parësore.
4. Në të gjitha DAR të përfshira në vlerësim është ngritur dhe funksionon komisioni multidisiplinor. Evidentohen vonesa në procesin e vlerësimit për shkak të mungesës së mjekut në përbërje të ekipit dhe kjo çështje do të jetë e pranishme për aq kohë sa ky anëtar i komisionit nuk është në varësi të MASR. Krahas mungesës së mjekut, komisioni multidisiplinor pranë DAR, i cili funksionon mbi baza vullnetare, për arsye të kohës dhe angazhimit të anëtarëve në punët e tyre kryesore, nuk ka mundësi dhe hapsirë kohore të vlerësojë në vazhdimësi, procesin e përfshirjes e të progresit për nxënësit me aftësi të kufizuara. Komisioni nuk kryen vlerësime të fëmijëve, të cilët paraqesin vëshirësi të aftësisë së kufizuar, por që nuk janë të deklaruar nga prindërit si të tillë apo që nuk kanë vërtetim të KMCAP-së. Ndonëse po përdoren nga disa DAR, forma të reja të vlerësimit, bazuar në manualin e botuar nga Save the Children për KNF, duke shtuar treguesit me nevojat në funksion të kryerjes së aktiviteteve dhe pjesmarrjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në procesin mësimor, këto forma dhe portokolle janë të paunifikuara dhe të pastandardizuara nga MASR. Krahas vlerësimit të nevojës për mësuesit ndihmës, gjithëpërfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte dhe shkolla të zakonshme, në varësi të llojit të aftësisë së kufizuar, kërkon vlerësim edhe për një sërë shërbimesh të tjera mbështetëse. Këto shërbime, të tilla si transporti i përshtatur, përkthyesi i gjuhës së shenjave, tekste të printuara në Braille, programe në gjuhë të thjeshtëzuar, mjete didaktike etj, referimi ose mbështetja specifike nga specialiste të shërbimit psiko-social, logopedë, fizioterapistë , duhet të jenë gjithashtu pjesë e një vlerësimi të standardizuar që i bëhet fëmijës nga komisioni multidisiplinor, në mënyrë të tillë që të reflektohet në Planin Edukativ Individual (PEI). Megjithatë ka përpjekje për një vlerësim të infrastrukturës mbështetëse (tekste Braille / interpret i gjuhës së shenjave/ tekste në formate të zmadhuara/mjete didaktike në ndihmë të punës me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe

⁷ VKM nr.708, datë 26.08.2015 parashtron kërkesa të reja për informacionin statistikor për fëmijët e të rriturit me aftësi të kufizuara, data baza duhet të plotësohet edhe me tregues të tjerë të cilët evidentojnë nevojat për shërbime mbështetëse për të garantuar arsim cilësor për fëmijët me aftësi të kufizuara

⁸Ligji nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, Dispozitat Normative dhe Ligji për përfshirjen dhe aksesueshmërinë (2014).

shërbimet e tjera mbështetëse, të cilat i nevojiten një nxënësi me aftësi të kufizuara), ky vlerësim nuk është i plotë, pasi mungojnë specialistë pranë komisioneve, të cilët mund të bëjnë vlerësimin për nevojat për mjete didaktike e shërbime mbështetëse.

5. Pranë çdo DAR është ngritur njësia e shërbimit psiko-social⁹ që lehtëson dhe asiston përfshirjen dhe mbarëvajtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte dhe shkolla të zakonshme. Efektiviteti i punës së njësisë lë për të dëshiruar për shkak të normës së lartë që psikologët kanë (1 psikolog për 1800-2000/ nxënës), mungesës së punonjësit social, si edhe mungesës së trajnimeve të vazhdueshme për trajtimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara sipas diagnozave të ndryshme. Janë zhvilluar trajnime të drejtuesve të shkollave, psikologëve dhe punonjësve socialë për përdorimin e manualit të hartuar në ndihmë të shërbimit psiko-social në shkolla për fëmijët me aftësi të kufizuara, por vetëm në shkollat ku aplikohen projekte të gjithëpërfshirjes, ndërkohë që është e domosdoshme shtrirja e këtyre projekteve në të gjitha institucionet arsimore, sidomos në shkollat e fshatit, e realizuar kjo jo vetëm prej organizatave (World Vision ka realizuar trajnime në 87 shkolla në zonat rurale) por përmes një qasjeje strategjike kualifikimi dhe formimin të profesionistëve në shërbimit, të planifikuar, buxhetuar dhe koordinuar nga MASR dhe IZHA.
6. Pranë çdo institucioni arsimor është ngritur dhe funksionon komisioni i vlerësimit, i cili duhet të hartojë PEI për çdo fëmijë me aftësi të kufizuara. Puna për zbatimin e planeve PEI vështirësohet dhe nuk ka efektivitet për shkak të: (a) mungesës së një formati të standartizuar të hartimit të planeve PEI për ta; (b) mungesës së materialeve të nevojshme/ mjeteve didaktike për realizimin e tyre; (c) pranisë për një kohë të shkurtër së mësuesve ndihmës, të cilët duhet të asistojnë një numër të caktuar fëmijësh brenda ditës, numrit të madh të nxënësve në klasën ku ndodhet fëmija me aftësi të kufizuara; etj; (d) mungesës së një sistemi të integruar që ofron shërbime të specializuara brenda institucioneve arsimore bazuar mbi arritjet dhe objektivat e PEI-t.
7. Megjithë përpjekjet e DAR/ ZA-ve, numri i mësuesve ndihmës mbetet ende shumë i vogël në raport me numrin e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe nevojat specifike që ato kanë në të mësuar. Aktualisht në institucionet arsimore, në 10 Bashkitë janë 149 mësues ndihmës me kohë të plotë dhe 20 mësues ndihmës me kohë të pjesshme(këta të fundit

⁹Urdhër i Ministrisë nr.344, datë 19.08.2013 “Për ngritjen e shërbimit psiko-social”.

në bashkinë Shkodër). Numrin më të madh të mësuesve ndihmës e ka DAR Vlorë, ndonëse edhe këtu nevojiten edhe 5 mësues të tjerë; DAR Elbasan raporton 1.5 herë më shumë nxënës me aftësi të kufizuara të përfshirë në sistemin arsimor, në raport me Bashkinë Vlorë, por ka vetëm 12 mësues ndihmës, ndërkohë që në Bashkinë Durrës, pranë DAR ka vetëm 3 mësues ndihmës kur numri i fëmijëve të përfshirë në sistemin arsimor është thuajse i njëjtë me numrin e raportuar nga DAR Vlorë. Mungesa e mësuesit ndihmës në klasa ku ka nxënës me aftësi të kufizuara, e bën pothuajse të pamundur mësimdhënien dhe gjithë procesin mësimor për ta. Evidentohet si problematik gjithashtu fakti se mësuesit ndihmës nuk përmbushin kriterin¹⁰ dhe nuk kanë përgatitjen e duhur për të punuar me fëmijët me aftësi të kufizuara.

8. DAR nuk kanë një plan për trajnimin e mësuesve kujdestarë, atyre lëndorë si edhe për mësuesit ndihmës që punojnë me fëmijët me aftësi të kufizuara¹¹. Trajnime për specialistët, përfshirë punonjësit social, psikologët dhe mësuesit, janë ofruar nga organizata të ndryshme, si MEDPAK, World Vision, Save the Children, UNICEF etj. në ,kuadrin e partneritetit të DAR dhe MASR me këto organizata, si edhe në mënyrë individuale nga vetë mësuesit. Ka manuale trajnimi të certifikuar nga IZHA, por mungojnë manuale trajnimi të unifikuar e të standardizuara nga MASR. Evidentohet nevoja për trajnime të mëtejshme e të thelluara në aspekte si: si të bëhet përcaktimi i orëve mësimore me mësues ndihmës; hartimi i PEI, metodika të punës me nxënës me aftësi të kufizuara; vlerësimi dhe mbështetja me shërbime të specializuara i nxënësve me aftësi të kufizuara, si të menaxhohen situata të agresivitetit/dhunës në raste kur ka fëmijë me aftësi të kufizuara që në momente të caktuara mund të jenë agresivë, mbështetja e bashkëmoshatarëve, teknika dhe strategji praktike për të menaxhuar klasën duke konsideruar nevojat unike që çdo fëmijë ka etj.
9. Në shkolla mungojnë qendrat burimore si mjedise brenda ambienteve të klasave institucioneve arsimore që do të ndihmojnë me punë individuale dhe të specializuar me çdo fëmijë me aftësi të kufizuara që paraqet vështirësi në klasë, që mbetet mbrapa dhe që ka nevojë për mbështetje për të lehtësuar pjesëmarrjen aktive të tij në procesin mësimor së bashku me bashkëmoshatarët. Shpesh, mungesa e shërbimeve mbështetëse nga specialistë si logopedistë, fizioterapistë, vështirësojnë procesin e të mësuarit për

¹⁰ Në bazë të udhëzimit të kenë përfunduar pedagogjinë speciale.

¹¹ Arsimi/ Objektivi I/Pika 1.6 në Planin e Veprimit të PAK

fëmijët me aftësi të kufizuara në shkolla gjithëpërfshirëse. Përpjekjet për ofrimin e këtyre shërbimeve, pranë institucioneve arsimore, në qendrat burimore, kanë filluar në fazë pilotimi në partneritet dhe me mbështetjen e World Vision. Ky shërbim ka nevojë të formësohet dhe standardizohet me ekspertë në nivel qendror e vendor.

10. Ndonëse pranë Bashkive Durrës, Elbasan, Korçë, Shkodër e Vlorë, funksionon edhe nga një shkollë speciale, ende nuk është marrë asnjë masë në drejtim të përmbushjes së detyrimit¹² për shëndërrimin e tyre në qendër burimore.
11. DAR dhe institucionet arsimore që operojnë në nivel vendor, nuk kanë hartuar një plan veprimi për të adresuar problematikën e aksesueshmërisë¹³, me gjithë detyrimin ligjor¹⁴ për ta bërë këtë. Deri tani vërehet se nuk është planifikuar në këtë drejtim, përfshirë në terma financiarë.
12. Nuk ka një rrjet formal të bashkëpunimit¹⁵ mes të gjitha institucioneve që janë përgjegjëse për të trajtuar çështjet e aftësisë së kufizuar në nivel vendor (institucione në sektorin e arsimit shëndetësisë punësimit, formimit profesional, shërbimeve sociale, strehimit, transportit dhe infrastrukturës) organizatave të personave me aftësi të kufizuara apo që kanë në fokus aftësinë e kufizuar. Bashkëpunimi me komunitetin e prindërve, informimi, ndërgjegjësimi dhe përfshirja reale e tyre, duke marrë edhe përgjegjësi në procesin e edukimit, konsiderohen si elemente të domosdoshme por ende jo gjerësisht të krijuara e konsoliduara për të arritur një edukim cilësor për fëmijët me aftësi të kufizuara¹⁶.

Në lidhje me njohjen e kuadrit ligjor e politik në fushën e arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, evidentohet se njihet mire Ligji për arsimin parauniversitar, dispozitat dhe aktet nënligjore në lidhje me këtë ligj, ndërkohë që ka mungesë të njohjes së akteve ligjore dhe politike specifike në fushën e aftësisë së kufizuar, të cilat direkt apo indirekt kanë lidhje edhe me arsimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Aftësia e kufizuar vazhdon të trajtohet e fragmentarizuar dhe sektoriale pa një qasje e bashkërendim ndërsektorial dhe

¹² Planin Kombëtar të Veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2016-2020

¹³ (a) aksesin fizik në objekte shërbimesh, terrere sportive, qendra kulturore, në rrugë dhe trotuare; (b) aksesin në informacion, përmes formateve të aksesueshme ose përmes ofrimit të shërbimeve online - në faqe interneti të aksesueshme; (c) aksesin në transport/transport të përshtatur.

¹⁴ VKM nr. 1074, datë 23.12.2015¹⁴ "Për masat e mënjanimit të pengesave mjedisore dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara" dhe ligji nr 139/2015 për veteqeverisjen vendore i cili ngarkon bashkitë me realizimin e infrastrukturës/mirembajtjes në cdo institucion shkollor.

¹⁵ Ka një ekspserincë të tillë në vitin 2017 të iniciuar nga Save the Children në Durrës dhe Vlorë që ka bërë të mundur krijimin e një rrjeti lokal për AK të koordinuar respektivisht nga Bashkia Vlorë dhe Durrës.

¹⁶ Arsimi/ Objektivit I/Pika I.I në Planin e Veprimit të PAK

ndërinstitucional. Ligji i arsimit parauniversitar e trajton shërbimin për fëmijën me aftësi të kufizuara, nën lanten e arsimit, Ligji i shërbimeve shoqërore nuk ka asnjë dispozitë që ndërlidh punën e specialistëve të shërbimeve me atë të profesionistëve në fushën e arsimit, ndërkohë që e njëjta frymë përshkon edhe legjislacionin në fushën e shërbimeve shëndetësore.

III. NDËRHYRJET NË NIVEL QENDROR PËR TË GARANTUAR ARSIM CILËSOR E GJITHËPËRFSHIRËS PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA.

Objektivi Strategjik: Fëmijët me aftësi të kufizuara gëzojnë të drejtën për arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës në të gjitha nivelet e sistemit arsimor.

1. MASR merr masa për fuqizimin e strukturave dhe kapaciteteve në të gjitha nivelet e shërbimeve arsimore.

1.1 MASR duhet të marrë masa për të ngritur një të strukturë të posaçme për çështjet e arsimit, sportit e rinisë për personat me aftësi të kufizuara, e cila do të udhëheqë përgatitjen, zbatimin, monitorimin e kuadrit ligjor e politik nën këndvështrimin e KNDAK, dhe të drejtave të njeriut duke garantuar planifikimin e masave dhe buxheteve specifike dhe gjithëpërfshirëse në fushën e arsimit, sportit, e rinisë;

1.2. MASR duhet të orientojë, financojë dhe monitorojë në vijimësi që DAR/ZA të kenë një staf përgjegjës për arsimin gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara/ apo që ta ketë arsimin gjithëpërfshirës të fëmijëve me aftësi të kufizuara detyrë parësore;

1.3. MASR dhe MSHMS të ndërmarrë hapat e duhur për përmirësimin e funksionimit dhe rritjen e efektivitetit të Komisionit Multidisiplinor pranë DAR, duke garantuar që ai të ketë një status të përhershëm. Njëkohësisht MASR duhet të:

(a) standardizojë format e vlerësimit që përdoren nga komisioni multidisiplinor pranë DAR;

(b) të standardizojë dokumentacionin që duhet të plotësohet dhe që shoqëron gjithë procesin mësimor të fëmijëve me aftësi të kufizuara;

1.4. MASR të shtojë çdo vit numrin e mësuesve ndihmës në bazë të vlerësimit dhe kërkesës nga çdo DAR /ZA në përputhje me nevojat e fëmijëve që ndjekin arsimin gjithëpërfshirës dhe në bazë të kritereve të udhëzimit 38/ 2014 të MASR për përzgjedhjen e tyre;

1.5. MASR duhet të ulë ngarkesën e psikologëve aktualë dhe të shtojë numrin e psikologëve dhe punonjësve social, me qëllim përmirësimin e shërbimit psiko- social në kopshte e shkolla;

1.6. Me qëllim kryerjen e rolit të strukturave/ profesionistëve të përfshirë në arsimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, MASR duhet të punojë për fuqizimin e kapaciteteve të tyre përmes:

- Hartimit, përditësimit, financimit/bashkëfinancimit dhe monitorimit në mënyrë periodike të një plani trajnimi për të gjitha strukturat e përfshira në arsimin gjithëpërfshirës;

- Ofrimit të trajnimeve të thelluara për: (a) stafin përgjegjës pranë MASR dhe DAR/ZA (b) Komisionin multidisiplinor të vlerësimit pranë DAR; (c) Komisionin e vlerësimit pranë çdo institucioni arsimor; (d) Mësuesit kujdestarë dhe mësuesit lëndorë; (e) mësuesit ndihmës; (f) njësinë e shërbimit psiko-social; (g) komunitetin e prindërve etj (h) nxënësit dhe bashkëmoshatarët mbi parimet e barazisë, gjithëpërfshirjes, empatisë dhe diversitetit në kuadër të orëve të lira ose zbatimit të nismave kombëtare si Shkolla si Qendër Komunitare. Në ndihmë të këtyre trajnimeve do të jenë materialet ekzistuese të përgatitura dhe të standardizuara nga MASR për këtë qëllim, materialet e propozuara për hartim e standardizim, që lidhen me vlerësimin bio-psiko-social dhe përdorimin e KNFsë, mbledhjen e të dhënave dhe statistikave, elementet e aksesueshmërisë, dhe metodat bashkëkohore për punën me këta fëmijë, bazuar në modele dhe praktika të suksesshme. MASR të parashikojë seanca trajnuese dhe informuese për DAR/ZA për çdo ndryshim të ndodhur në kuadrin ligjor e politik, si specifik ashtu edhe gjithëpërfshirës, i cili ndikon direkt apo indirekt në edukimin, pjesëmarrjen në aktivitete sportive, pjesëmarrjen në programet rinore të personave me aftësi të kufizuara.

2. MASR duhet të hartojë plane vjetore, të cilat duhet të ndiqen dhe mbi të cilat duhet raportuar periodikisht mbi realizimin e detyrimeve në zbatim të dokumenteve ligjorë e politikë për arsim cilësor e gjithëpërfshirës dhe përgjatë gjithë ciklit të jetës për fëmijët me aftësi të kufizuara në Shqipëri.

3. MASR duhet t'u kërkojë DAR/ZA përgatitjen e planeve vjetore për gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara, të mbështetura këto në planin e MASR dhe në dokumente ligjorë e politikë dhe duhet të monitorojë zbatimin e tyre, bazuar në indikatorët e përcaktuar paraprakisht.

4. MASR, duhet të hartojë para së gjithash vetë, dhe të kërkojë nga të gjitha DAR/ZA dhe institucionet arsimore të të gjitha niveleve, përfshirë ato private, të përgatisin një plan masash, përfshirë me buxhetet përkatëse dhe me afate kohore, për mënjanimin e pengesave në komunikim, infrastrukturë dhe transport, në shërbimet arsimore të të gjitha niveleve për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, (persona me vështirësi në lëvizje, persona të verbër, persona që nuk komunikojnë, persona me aftësi të kufizuara intelektuale) dhe të monitorojë çdo vit zbatimin e tyre.

5. MASR duhet të punojë për krijimin dhe standardizimin e modelit të qendrës burimore brenda klasave dhe institucioneve arsimore, në ndihmë të mësuesit mbështetës dhe profesionistëve nga shërbimi psiko-social dhe specialistë të tjerë që identifikohen si të rëndësishëm nga komisioni multi-disiplinor për punë individuale, me qëllim që fëmija me aftësi të kufizuar të mund të avancojë në shkallën më të lartë të mundur me ritmin e bashkëmoshatarëve të vet. Pranë qendrës burimore, nisur nga nevojat në bazë të vlerësimit të KMCAP dhe vlerësimi pranë DAR, fëmijës me aftësi të kufizuara që ndjek sistemin arsimor, t'i ofrohen edhe terapi të tjera, përfshirë logopedi, fizioterapi e terapi psiko-sociale. MASR në bashkëpunim me MSHMS dhe Bashkitë financojnë/gjenerojnë fonde për funksionimin e qendrave burimore, përfshirë stafin mbështetës, profesionistët, bazën materiale dhe atë didaktike dhe krijimin e kapaciteteve.

6. MASR duhet të marrë masa për kthimin e shkollave speciale në qendra burimore, përfshirë (a) krijimin e ambienteve të ndara në shkollën speciale dhe hartimin e kurrikulave të trajnimit në mënyrë që ato të mund të përdoren si qendër burimore për mësuesit e zakonshëm dhe mësuesit ndihmës që do të punojnë me fëmijët me aftësi të kufizuara; (b) Trajnimin dhe certifikimin e personelit në shkollat speciale në mënyrë që ata të mund të veprojnë si trajnerë; (c) Ndërtimi i infrastrukturës së mësimdhënies dhe materialeve didaktike në qendrat burimore; (d) Përgatitja e botimeve për specialistët dhe prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara; (e) Hartimi i metodologjisë për funksionimin e shkollave speciale si qendra burimore etj

7. MASR duhet të përmirësojë sistemin e mbledhjes dhe raportimit të të dhënave për fëmijët me aftësi të kufizuara të përfshirë në të gjitha nivelet e sistemit arsimor. Realizimi

i objektivit kërkon angazhimin e MASR për të plotësuar bazën e të dhënave ekzistuese¹⁷ me tregues të rinj të domosdoshëm, të cilët do të shërbejnë për të pasqyruar të dhëna për nevojat specifike në të mësuar të fëmijëve me aftësi të kufizuara, bazuar në vlerësimin me bazë KNF. MASR, duhet t'u kërkojë të gjitha institucioneve rajonale dhe lokale, të mbledhin të dhëna dhe të raportojnë, në përputhje me VKM. Nr. 708 Datë 26.8.2015 "Për llojet, periodicitetin dhe mënyrën e raportimit të të dhënave statistikore për aftësinë e kufizuar nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor", e cila parashikon garantimin e të dhënave administrative për personat me aftësi të kufizuara në nivel qendror e vendor si edhe kryerjen e anketimeve të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara kryesisht nga INSTAT.

¹⁷Baza e të dhënave ekzistuese është e unifikuar nga MAS për të gjitha DAR e ZA me qëllim raportimin e të dhënave për numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara të përfshirë në kopshe dhe shkolla të zakonshme në vend.